

SHKALLËT E ATRIBUIMIT NË SHKRIMIN E EDITORIALEVE

Samir AVDIAJ¹

^{1*} Center of Competence "Kujtim Krasniqi", Malishevë, Kosovo

*Corresponding author's e-mail: samiravdiaj@hotmail.com

Abstract

According to Mallet's perspective, the crux of an editorial lies in its embodiment of the social, moral, or political stance of the publisher, acting on behalf of the newspaper, concerning specific issues. The author's standpoint on the subjects at hand must be lucidly evident, necessitating a firm position taken related to the problem under consideration. Although editorials commonly appear without individual attribution, the ethical and legal responsibility in such cases rests with the publication's editorial board. It remains pivotal that the editorial commentary remains distinctly separate from the news content.

This study aims to elucidate the author's demeanor when composing an editorial, setting it apart from other genres within journalism where the journalist traditionally abstains from personal inclinations and focuses solely on presenting facts. Adjectives lend color and nuance to nomenclature; however, the application of adjectives that convey particular attitudes is primarily reserved for subjective texts, impressionistic depictions, commentaries, and narratives. Similar classifications extend to adverbs as well (L. Rugova & Bardh Rugova, 2015: 169). The theory (Witaker et al., 2004: 1010) referenced through Rugova (2009: 199) suggests a principle for written media – encompassing newspapers, broadcast outlets, and public relations – advocating for prudence in the use of adverbs and adjectives. Hence, we posit that within this chosen analytical framework, attribution will be abundant, yet the extent of usage will fluctuate amongst different authors.

Keywords: Attribution, Epithet, Convention, Adverb, Editorial.

Atribuimi në editorialet e gazetës “ZËRI”

1. Sfondi teorik

Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër, për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi. Mbiemri ka kategoritë gramatikoretë gjinisë, të numrit, për një pjesë edhe të rasës, të varura nga kategoritë e emrit. Veç kësaj ka edhe kategoritë e shkallës, të cilën emri nuk e ka. Kuptimi katëgorial i mbiemrit është kuptimi i tiparit të sendit, pra të emërtuarit e një cilësie, vetie a marrëdhënieje karakteristike dalluese të këtij sendit. P.sh. *Pushka e gjatë. Ç'u bë vullnetar i palodhur i hekurudhës, që mbush vagona me gurë e me dhe?* (ASHSH, 2002: 153). Mbiemrat klasifikohen sipas dy kriterëve, pra sipas kuptimit të tyre leksikor dhe sipas vetive të tyre morfologjike. Sipas Demirajt (1980: 103-107), në periudhën e dokumentuar të shqipës mbiemri paraqitet dy farësh, i nyjeshëm dhe i panyjeshëm.

Kjo gjendje është përfundimi i zhvillimit historik të shqipes, e cila në një fazë më të hershme, ashtu si gjuhët e tjera indioevropiane, ka pasur vetëm mbiemra të nyjeshëm. Procesi i paranyjesimit të mbiemrave në gjuhën shqipe ka nisur që në kohëra relativisht të hershme. Për këtë dëshmon, ndër të tjera, edhe fakti që mbiemrat e nyjeshëm janë në përdorim të dendur në të gjitha të folmet e shqipes, duke përfshirë këtu edhe të folmet arkaike të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë. Ndërsa sipas Gramatikës së ASHSH-së (2002: 155), duke u nisur nga ajo se çfarë tipari emërtojnë, gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe mund të ndahen në dy grupe të mëdha: a. mbiemra që tregojnë cilësi, të cilët do të quhen mbiemra cilësorë dhe b. mbiemra marrëdhëniorë që japin tiparin, emrit të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërimit të marrëdhënive të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim a me një numër.

Sipas L. Loshit (2005: 70) vendosja e një mbiemri në togfjalësh me një emër nuk është të emërtuarit e një cilësie, vetie a marrëdhënieje karakteristike dalluese të sendit, siç na mëson gramatika. Cilësimi është edhe nxjerrja në dukje e diçkaje të brendshme për sendin, dukurinë a qenien, zbulimi ose vendosja e një lidhjeje, një vlerësim që bëhet nga një pikëvështrim deri edhe krejt vetjak, subjektiv, ose, më në fund edhe një veprim mbi atë që shënon emri, një shndërrim ose shformim i saj. Zgjedhja e mbiemrit është si treguese e një vlerësimi, edhe e një qëndrimi, prapa të cilit është një mënyrë vështrimi a konceptimi të botës. Epiteti është një mbiemër plus vlerësimin, vështrimin dhe veprimin e ligjëruesit, ose epiteti = mbiemër + subjekti i ligjëruesit.

Sipas Rugovës (2009: 200) mbiemrat cilësorë dhe ndajfoljet përcaktuese shërbejnë për të sqaruar, por dhe për të kualifikuar dhe, së këndejmi, janë mjete që do të mund ta bënin të diskutueshëm konceptin e objektivitetit në kontekste të caktuara. Mbiemrat marrëdhëniorë janë më neutralë sepse paraqesin tipare të qëndrueshme të sendeve ose të frymorëve, por në situata figurative mund të jenë joobjektive. Edhe të ndajfoljet egziston një ndarje, sipas së cilës, ato rrethanore janë më neutrale se ato përcaktuese, joneutrale.

Klasifikimi i mbiemrave të shqipes nuk i merr parasysh konceptet e gramatikës së tekstit. Kur të merret parasysh nocioni i këndvështrimit të tekstit, duke e parë përfaqësimin në tekste objektive dhe subjektive, ndarja në mbiemra cilësorë dhe marrëdhëniorë nuk mjafton sipas Lindita Rugovës & Bardh Rugovës (2015: 167). Andaj mbi këtë bazë mbiemrat e shqipes mund të ndahen në mbiemra që shprehin qëndrim dhe mbiemra që nuk shprehin qëndrim. Dallimi i mbiemrave që shprehin qëndrim kundruall atyre që nuk shprehin qëndrim shprehet mbi ekzistimin ose jo të një konvente, këndi kuptimor a marrëveshjeje mbi të cilën kryhet përcaktimi. Kategoria e shkallës, sidomos asaj krahasore e sipërore, ka gjithnjë në vetvete një ngjyrim vlerësues. Sipërorja absolute është karakteristike për tonin oratorik e solemn dhe si teprim i gazetarisë propagandistike (Lloshi, 2005: 71).

2. Editoriali dhe të veçantat e tij në gazetën “ZËRI”

Gazeta “Zëri”, është njëra ndër gazetat e përditshme kosovare e cila përveç të tjerash e ka edhe shkrimin e saj të editorialit. Përndryshe nga disa gazeta të tjera kosovare të cilat editorialin e plotë e botojnë në ballinë, kjo gazetë zakonisht në ballinë e jep vetëm një pjesë të këtij shkrimi, zakonisht dy apo tre paragrafë, ndërsa pjesën tjetër e gjejmë në faqën e dytë. Kjo është karakteristikë e kësaj gazete dhe njëherit një mënyrë e mirë për ta nxitur lexuesin ta lexoj editorialin të plotë në anën e majtë. Gazeta “Zëri” i jep një rëndësi të veçantë editorialit për të treguar qëndrimin e saj redaksional dhe pikërisht botimi i editorialit jo të plotë në ballinë të gazetës ia shton edhe më shumë rëndësinë.

Rubrika e veçantë nga lajmet tjera ditore dhe vendosja në anë të djathtë të ballinës e bën më të dukshme për lexuesit këtë shkrim. Ndërsa, teksti është i vendosur në një shirit të gjatë, por jo i plotë në mënyrë vertikale, diku kah mesi i shkrimit e gjejmë edhe fotografinë e autorit, adresën për kontakt dhe fjalinë më thelbësore të editorialit, duke e bërë më të dallueshme në mesin e lajmeve të tjera ditore dhe duke e nxitur kureshtjen e lexuesve për ta lexuar më tutje.

Kurse, shkrimin e plotë mund ta gjëjmë në faqën e dytë të gazetës, në anën e majtë. Gjatësia e tekstit nuk është çdoherë e njëjtë, ngaqë nuk jepet shkrimi i plotë. Mbi titull shënon “Editoriali”, duke e përcaktuar qartë zhanrin e shkrimit. Autorësia është e qartë, ngaqë çdoherë te kjo gazetë, ky lloj shkrimi jepet me emër dhe mbiemër të plotë të autorit dhe zakonisht emrat të cilët kujdesen për këtë lloj shkrimi nuk janë të shumtë. Ata janë: Arbana Xharra, Behxhet Halili, Beqë Cufaj, Ibrahim Rexhepi, Astrit Gashi, Ardian Çollaku, Dush Gashi dhe Binak Kelmendi. Po ashtu këta autorë është karaktërsitikë se nuk shkruajnë çdo ditë, d.m.th. një autori zakonisht i bjen të shkruajë një herë në javë dhe nga kjo mund të themi se shkrimet sigurisht do të jenë më efektive, ngaqë trajtimi i temave nuk bëhet shpejt.

Edhe pse si rregull editoriali botohet pa emër, te gazeta “Zëri” e gjëjmë me emër dhe mbiemër. Pavarësisht kësaj përgjegjësia shoqërore dhe juridike në këtë rast i përket redaksisë së gazetës (Boriçi, 2002: 173). Për gazetën, gjithnjë është e rëndësishme që opinioni redaksional të mos zëvendësohet nga lajmet, po aq sa është e rëndësishme që përmes rreshtave të lajmeve të mos futet komenti redaksional. Shkrimi i editorialeve tregon edhe vazhdimin e programit botues apo politik të gazetës. Nga teoricientë të ndryshëm janë bërë përpjekje të shumta sa i përket klasifikimit të editorialeve në gazetarinë shqiptare. Por e gjitha kjo arrin të kurorëzohet me klasifikimin që i bën Hamit Boriçi (f. 175).

Ai editorialin e klasifikon kështu: “editorial operativ, i përgjithshëm politik dhe propagandistik”, por sipas Kosumit (2008: 78), në gazetarinë shqiptare kohëve të fundit gjëjmë edhe editorialin e temës. Krejt ky klasifikim mund të themi se është bërë pikërisht nga synimi që ka autori për të shkruar. Temat të cilat trajtohen në editoriale shtrohen te synimet imediate që do të arrijë redaksia me ata editoriale, pra ndarja sipas Boriçit (2002: 175), përcaktohet nga synimet, nga prirjet e një brendie të caktuar. Struktura e këtij lloj shkrimi mund të dallohet qartë nga shkrimet tjera publicistike, ngaqë përbëhet nga një hyrje, duke u pasuar pastaj nga paragrafë të tjerë të cilët ofrojnë argumentet e autorit për temën dhe i gjithë ky lloj shkrimi përfundon me qëndrimet e autorit, përkatësisht redaksisë, pra autori qartëson pozicionet e tij apo të redaksisë në lidhje me temën (f. 174).

Është e vështirë të konceptohet një artikull-editorial pa direktivë, pa orientim e pa udhëzime, qoftë të hedhur edhe në mënyrë të tërthortë, të nënkuptuar (f. 177). Esenca e editorialit është se ai duhet të ketë pozicionim shoqëror, politik, moral apo publik të botuesit, në emër të gazetës, për çështje të caktuara. Autori duhet të ketë qëndrim të qartë për çështjen që trajton, pra duhet të marrë një pozicionim për temën e trajtuar (M .F. Mallet, 2003: 70).

2.1. Metodologjia e punimit: Objekt i këtij studimi është ndryshimi morfologjik, përkatësisht, *Shkallët e atribuimi në editorialet e gazetës “Zëri”*. Ky hulumtim ka për qëllim nxjerrjen e rezultateve konkrete mbi shkallën e atribuimit brenda shkrimeve gazetareske, veçanërisht editorialit.

Për studim janë zgjedhur gjashtë editoriale të Gazetës “Zëri”, të janarit të vitit 2010, të dy autorëve të ndryshëm. Emrat që më se shpeshti i gjëjmë si autorë të këtij lloj shkrimi janë: Arbana Xharra, Behxhet Halili, Beqë Cufaj, Ibrahim Rexhepi, Astrit Gashi, Ardian Çollaku, Dush Gashi dhe Binak Kelmendi, por ne jemi munduar t’i gjëjmë autorë të të dy ekstremeve, pra ata që shprehin qëndrim personal, përtej qëndrimit të redaksisë dhe tjetri që kursehet nga këto qëndrime, mundohet ta shpërfaq vetëm qëndrimin e redaksisë.

Paraprakisht janë analizuar editoriale të shumta, pastaj nga gjashtë autorë, sa merreshin me këtë lloj shkrimi zakonisht, kemi veçuar; Arbana Xharren dhe Ibrahim Rexhepin. Përvoja gazetareske e këtyre dy autorëve, veçanërisht asaj të shkruar (shkrimi të editorialit) është mjaft e gjatë, pothuajse sa vet medium të cilin e përfaqësojnë në këtë rast. Fillimisht është bërë një vështrim i përgjithshëm i këtij lloj shkrimi, pastaj janë veçuar vetëm rastet të cilat kanë shërbyer për të matur shkallët e atribuimit.

Pra, janë veçuar dhe analizuar mbiemrat dhe ndajfoljet të cilat shprehin qëndrimin e autorit, në këtë rast edhe të redaksisë. Pastaj janë ndarë mbiemrat nga ndajfoljet, fillimisht në mbiemra cilësorë dhe ndajfolje përcaktuese, duke lënë anash mbiemrat marrëdhëniorë dhe ndajfoljet rrethore. Pas këtij klasifikimi, kemi vazhduar me epitete, duke e analizuar kontekstin në të cilin janë përdorur brenda fjalisë, ngaqë jo çdoherë i njëjti mbiemër ose ndajfolje mund të cilësohet si epitet.

Hipotezat e këtij studimi janë:

- Ngaqë editoriali paraqet qëndrimin e redaksisë në lidhje me tema të ndryshme, si: politike, ekonomike, sociale, gjithsesi pjesë e pandashme e këtyre shkrimeve është edhe atribuimi,
- Atribuimi është pjesë e pandashme e këtyre shkrimeve, por shkalla është ajo që dallon nga autori në autorë.

2.2. Analiza dhe rezultatet: Sipas Hudson (2002: 190), ndryshoret sociolinguistike mund të dallohen sipas nivelit të gjuhës (fonetike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore), në të cilat variantet janë të ndryshme.

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë ndryshoret morfologjike. Përmes këtij hulumtimi do të sjellim një klasifikim të detajuar sa u përket përdorimit të mbiemrave dhe të ndajfoljeve që shprehin qëndrimin e autorit dhe redaksisë. Tabela e mëposhtme do të shërbejë për të parë konkretisht numrin dhe përqindjen e mbiemrave dhe ndajfoljeve, përmes të cilëve autorët kanë shprehur qëndrimin personal dhe të redaksisë. Andaj, përmes këtij klasifikimi njëherit e kemi parë saktësisht shkallën e atribuimit.

Autorët	Mbiemra		Ndajfolje		Gjithsej fjalë
	Epitet	Konventë	Epitet	Konventë	
Arbana Xharra	3.77%	2.25%	1.08%	1.88%	1,377
Ibrahim Rexhepi	2.87%	1.66%	0.74%	1.76%	1,079

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet qartë se shkalla e atribuimit dallon nga autori në autorë, sa i përket këtij zhanri gazetaresk. Vërehet se Arbana Xharra, sa i përket përdorimit të mbiemrave dhe ndajfoljeve, përdor më dendur atribumin krahasuar me shkrimet e Ibrahim Rexhepit. Po ashtu, qoftë përmes mbiemrave, qoftë përmes ndajfoljeve, kur Xharra i përdor si epitete, ka shkallë më të lartë të atribuimit. Duke e parë ndërlidhjen e editorialit me kryeartikullin, mund të themi se nganjëherë e kalon qëndrimin redaksional përmes atribuimit të problemit.

Kemi vërejtur se Arbana Xharra, ka shprehur qëndrimin e saj me një përqindje rreth 1.10% më shumë sesa Ibrahim Rexhepi, përmes mbiemrave (epitetë), ndërsa kur ndajfoljet janë zgjedhur për të shprehur qëndrimin, dallimi mes këtyre dy autorëve është me një përqindje më të vogël, me rreth 0.40%. Sipas Halliday dhe Hasan, cituar sipas B. Rugovës (2015: 87), përcaktorët mund të ndahen në pesë grupe: deiktivë, numërorë, epitete, klasifikues dhe kualifikues. Mbiemrat si përcaktorë më tutje mund të jenë epitete, duke shprehur referencë të objektit (tren i gjatë) dhe klasifikues, duke shprehur referencë të nënklasës (tren ekspres).

Në rastin e parë vërehet qëndrim i folësit, ndërsa në rastin e dytë nuk vërehet qëndrim. Andaj, bazuar në këtë klasifikim (i cili edhe për ndajfoljet është i njëjtë), në vazhdim do të sjellim disa shembuj, të shkëputur nga editorialet e Arbana Xharrës dhe Ibrahim Rexhepit.

1. *Madje, ai do ta ketë shumë problem të identifikoj së cili është më i mirë në një ekip të keq.*
2. *Dorën në zemër, edhe kritikuesit e kësaj ideje-kryesisht partitë **opizitare**, nuk kanë dhënë ndonjë argument të qëndrueshëm, pos atij se autostrada po shkon kah “arat e ministrit, Fatmir Limaj”.*
3. *Arsyet, për mua, kryesore, që e rëndojnë këtë vit janë këto që po i numërojmë **poshtë**:*
4. *Serbia, që në fillim mori presidencën e radhës së CEFTA, do të shtoj barrierat ndaj nesh për të penguar sa më shumë rritjen e eksportit, që edhe ashtu është i vocërr.*
5. *Banka **Botërore** në Prishtinë ka thënë troç se ka kohë për ato kredi.*
6. ***Sivjet**, si dhe dy vjet më vonë, s’do të ketë rritje të pagave, mësohet nga planifikimet **buxhetore** të Qeverisë së Kosovës.*
7. *Euforia do të marrë më vete edhe shpresat e kosovarëve për të përmirësuar jetën, për t’i dërguar diku larg nga ne.*
8. *Ndoshta edhe **këtu** i ndihmojnë, miqtë **ndërkombëtarë**.*
9. *Ndotja vazhdon, kurse projektet madhore bëhen jashtë planeve.*
10. *Në dhjetorin e **parvjetshtëm** u fol për projektet e njëjta që po dëgjohen edhe këtë janar.*

Përfundime

Nga një analizë e detajuar vijnë në përfundim se në mesin e rreth 2,456 fjalëve, përmes të cilave janë ndërtuar editorialet, 117 të këtyre fjalëve janë mbiemra apo 6.64%, ndërsa 68 ndajfolje apo 2.76%. Në mesin e 6.64% të hapësirës të cilën e kanë mbuluar mbiemrat 3.91% janë epitete, ndërsa 2.73% koneventë. Pjesa tjetër përmes të cilës vërehet (mos) qëndrim i autorit apo redaksisë janë edhe ndajfoljet të cilat kanë zënë një pjesë dukshëm më të vogël të hapësirës. Në mesin e këtyre ndajfoljeve, 1.82% janë epitete, ndërsa 3.64% janë koneventë.

Esenca e editorialit është se ai duhet të ketë pozicionim shoqëror, politik, moral apo publik të botuesit, në emër të gazetës, për çështje të caktuara. Autori duhet të ketë qëndrim të qartë për çështjen që trajton, pra duhet të marrë një pozicionim për temën e trajtuar. Nëse analizohet qëndrimi ose mungesa e qëndrimit të autorit në lidhje me temën e editorialit, atëherë kjo dallon nga autori në autorë. Pasi, në këtë hulumtim, i kemi veçuar dy autorë, atëherë kemi vërejtur se Arbana Xharra ka shprehur qëndrimin e saj me një përqindje rreth 1.10% më shumë sesa Ibrahim Rexhepi, përmes mbiemrave (epitetë), ndërsa kur ndajfoljet janë zgjedhur për të shprehur qëndrim, dallimi mes këtyre dya autorëve është me një përqindje më të vogël, me rreth 0.40%.

Nga krejt kjo kuptojmë se shkrimi i editorialit më shumë del si shkrim subjektiv se sa objektiv. Por, jo çdoherë përmes këtyre shkrimeve shprehet vetëm qëndrimi i redaksisë, nganjëherë autori i editorialit mund të dalë jashtë qëndrimit redaksional, qoftë me temën që ka zgjedhur për trajtim, qoftë më kahjen që i ka dhënë temës. Për ta matur këtë gjithmonë e kemi parë temën e editorialit, duke e krahasur me kryeartikullin e mediumit (gazetës). Vlen të përmendet se subjektivizmi i autorit ka ardhë si rezultat i vet zhanrit gazetaresk.

Referencat

- [1]. Boriçi, Hamit (2001). *Gazetaria 2*, Tiranë.
- [2]. Demiraj, Shaban (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, ETMM i KSAK, Prishtinë.
- [3]. Grup autorësh. *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I* (2002), Tiranë.
- [4]. Hudson. A.Richard (2002). *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë.
- [5]. Kosumi, Bajram (2008). *Editoriali, Komenti, Analiza*, Prishtinë.
- [6]. Lloshi, Xhevat (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Prishtinë.
- [7]. *Manual për gazetarët e Evropës Qendrore...*, red. nga M .F. Mallet, Dituria, 2003, fq. 70.
- [8]. Rugova, B. & Sejdiu- Rugova, L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Trembelat, Prishtinë.
- [9]. Rugova, Bardh (2009). *Gjuha e gazetave*, Prishtinë.